



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“TVN CABLE – TV” Sh.P.K

Nr. i biznesit 601216577

Pronar – Naim Rrustemaj

OK “TVN CABLE TV”

Rr: Dëshmorët e Kombit, hyrja N-5

Prishtinë

Ref: 1508/1038/LIC/II

Vendim

për licencimin e Operatorit Kabllor, “TVN CABLE TV” me seli në Prishtinë për të ofruar shërbime në komunën e Prizrenit, Mitrovicës dhe të Skenderajt

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Kandidati “TVN CABLE TV”ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë, më datën 8 korrik 2015.

Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.

5. Komisioni vlerëson se, kandidati “TVN CABLE TV” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor, në pajtueshmëri me Nenin 7 të Rregullores CIMC 2007/04.
6. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj, Komisioni i KPM-së vlerëson se, një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve, ndërsa kandidati “TVN CABLE TV” ka dorëzuar një listë prej 52 kanaleve.
7. Kandidati për operator kabllor “TVN CABLE TV” do të ketë të drejtë të bart, në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit për bartjen e kanaleve përmes rrjetit kabllor.
8. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator kabllor “TVN CABLE TV” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në rrjetin e tij kabllor, dhe mund të zgjerojë listën e programeve në të ardhmen. Kandidati “TVN CABLE TV” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
9. Komisioni, vlerëson se “TVN CABLE TV” ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2013/04.
10. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “TVN CABLE TV” ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

11. Komisionit i KPM-së merr vendim që, kandidatit “TVN CABLE TV” i cili planifikon të operojë në Komunën e Prizrenit, Mitrovicës dhe të Skenderajt, t’i lëshojë licencën e KPM-së për operatorë kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes operatorit kabllorë, për të cilat posedon marrëveshje valide për transmetim përmes sistemit kabllor.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë e tij si operatorë kabllorë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.


Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



21.09.2015
datë